

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

LIGJET DHE TATIMET NË KOSOVË

Zgjidhjet

P4

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 08.08.2020

CONTENT / PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga <u>ShKÇAK-PIKET E DHËNA</u>
A. Zgjidhje shumëfishe	20	
B. Zgjidhje opcionale	20	
C. Pyetjet problemore		
1. Problemi 1	15	
2. Problemi 2	12	
3. Problemi 3	7	
4. Problemi 4	10	
5. Problemi 5	8	
6. Problemi 6	8	
Total	100	

Pjesa A. Detyra me zgjidhje të shumëfishtë - nga 2 pikë secila (vetëm një përgjigje është e saktë)

1. Qiradhënësi, një biznes tregtar, lëshon faturën për muajin Korrik 2020 për një pasuri në baza mujore qiramarrësit "KLERTI" shpk. Vlera e faturës është 2,300.00 Euro plus Tvsh. Në ndërkohë menaxhmenti i kompanisë qiradhënëse i ka lëshuar një notë kreditore në vlerë prej 30% e vlerës së faturës si mbështetje financiare për shkak të situatës së pandemisë me COVID-19. Sa duhet të deklaroj dhe paguajë tatim në qira, qiramarrësi "KLERTI" shpk për muajin Korrik 2020. Fatura është subjek i tatimit të qirasë sipas normës së aplikueshme të ligjit në Kosovë.
 - a) 144.90 Euro;
 - b) 170.98 Euro;
 - c) 207.00 Euro;
 - d) 244.26 Euro.

2. Tatimpaguesi e ka të drejtën për të bartë kreditimin e TVSH-ës tek periudha e ardhshme tatimore:
 - a) Nëse shuma e tatimit të llogaritur është më e lartë se shuma e tatimit të zbritshëm;
 - b) Nëse shuma e tatimit të zbritshëm është më e lartë se shuma e tatimit të llogaritur;
 - c) Nëse shuma e tatimit të zbritshëm është e barabartë me shumën e tatimit të llogaritur;
 - d) Asnjëra më lartë.

3. Nëse Qeveria e Kosovës si pjesë e politikës për rimëkëmbje ekonomike për shkak të pandemisë me virusin COVID-19, vendos që për sektorin e gastronomisë të aplikohet norma e Tvsh-së prej 8% në vend të 18% për të gjitha produktet dhe shërbimet dhe sektori i gastronomisë nuk i ndryshon çmimet e shitjes, atëherë sa do të jetë përfitimi shtesë në përqindje për sektorin e gastronomisë nga kjo masë:
 - a) 8.47%
 - b) 9.00%;
 - c) 9.26%;
 - d) 10.00%;

4. Rian Krasniqi në muajin Dhjetor 2019 si punëtor me pagë primare ka pasur rrogën Bruto prej 760.00 Euro. Në Janar të vitit 2020, menaxhmenti vendosi që paga e Rianit të rritet për Neto vlerë prej 40.00 Euro. Sa do të jetë paga Bruto në Janar të vitit 2020 për Rianin?
 - a) 706.20 Euro;
 - b) 796.00 Euro;
 - c) 804.44 Euro;
 - d) 806.78 Euro.

5. Për qëllime tatimore për njohjen e KMSH në fund të vitit cilat metoda lejohet për trajtimin/vlerësimin e stokeve?
- a) metodat LIFO dhe FIFO;
 - b) metodat FIFO dhe Kosto mesatare;**
 - c) metodat Kosto mesatare dhe LIFO;
 - d) metodat FIFO, LIFO dhe Kosto mesatare;
6. Shoqëria tregtare që ka qarkullimi neto për vitin 2019 në vlerë prej 2,300,000 Euro dhe numri mesatar mujor të punëtorëve gjatë vitit 2019 prej 18, për qëllime të raportimit financiar, kjo shoqëri tregtare klasifikohet si:
- a) Shoqëri tregtare e madhe;
 - b) Shoqëri tregtare e mesme;
 - c) Shoqëri tregtare e vogël;**
 - d) Shoqëri tregtare mikro.
7. Fature në vlerë prej 850.00 Euro (përfshirë Tvsh) që është kalkuluar gabimisht me Tvsh prej 8% duhet të korigjohet me normën standarde. Në të njëjtën ditë është kthyer edhe një pjesë e mallit në këtë faturë i cili kthim poashtu duhet rregulluar në faturë. Malli i kthyer ka pasur kosto 50.00 Euro. Sa duhet të jetë vlera e faturës përfshirë Tvsh me norme standarde 18% pas korigjimit?
- a) 800.00 Euro;
 - b) 869.70 Euro;**
 - c) 874.07 Euro;
 - d) 878.70 Euro.
8. Kompania "ABC", në Qershor pranon një notë kreditore nga kompania "CBA" për blerjet të cilat i ka bërë para dy muajve nga kjo e fundit. Nota kreditore e pranuar nga "CBA" është në vlerë 179.80+Tvsh 18%. Për kompaninë "ABC" kjo notë ka ndikim që:
- a) zvogëlohen blerjet, rrit Tvsh e zbritshme;
 - b) zvogëlohen blerjet, rrit Tvsh e llogaritur;**
 - c) zvogëlohen shitjet, rrit Tvsh e zbritshme;
 - d) zvogëlohen shitjet, rrit Tvsh e llogaritur.

9. Kompania "Riani" shpk importon me 03 janar 2020 një kamion nga Gjermania. Vlera e faturuar nga kompania gjermane është 7,000 Euro. Kosto e transportit nga Gjermania në Kosovë është 1,000 Euro. Dogana e Kosovës me rastin e importit të kësaj blerje investive ka bërë rivlerësim të asetit për të cilën kanë vendosur bazën e re doganore sipas katalogëve përkatës në vlerë prej 12,000 Euro. Poashtu sipas kalkulimeve në Dokumentin Unik Doganor (DUD) kjo bazë i nënshtrohet normës 10% taksë doganore dhe 18% Tvsh. Kompania "Riani" e ka pranuar bazën e paraqitur nga Dogana. Sa duhet të jetë shpenzimet e zhvlerësimit të lejura për qëllime tatimore pëvitin 2020 për kompaninë "Riani" shpk?

- a) 1,760.00 Euro;
- b) 1,840.00 Euro;**
- c) 2,171.20 Euro;
- d) 2,640.00 Euro;

10. Kompania FLANDRA shpk merr mallra nga disa furnitorë të vet me marrëveshje me konsignacion. Si duhet të trajtohen mallrat e dhënë/marrë me konsignacion?

- a) Regjistrohen si mallra në stoqe tek FLANDRA shpk;
- b) Regjistrohen si mallra në stoqe tek furnitorët;**
- c) Regjistrohen si shitje nga ana e furnitorëve;
- d) Regjistrohen si blerje nga ana e FLANDRA shpk;

1. Mospagesa e detyrimit tatimit ne kohen e parapare me ligjet tatimore, bazuar ne Ligjin Për Administratën Tatimore dhe Procedurat do te paguaje një interes prej 0.56% ne muaj apo pjese te muajit.

E saktë

E pasaktë

2. Sipas ligjit të TVSh-së, tatimi i llogaritur kuptojmë - Tvsh-në në furnizimet të cilat i bënë personi i tatueshëm ose mallrat që i eksporton personi i tatueshëm.

E saktë

E pasaktë

3. Sipas ligjit nr. 06/L-016 për "Shoqëritë tregtare", çdo Shoqëri Tregtare duhet të ketë së paku dy Përfaqësues të Autorizuar (Drejtori dhe Agjenti).

E saktë

E pasaktë

4. Mospagesa e detyrimit tatimit ne kohen e parapare me ligjet tatimore, bazuar ne Ligjin Për Administratën Tatimore dhe Procedurat do te paguaje një gjobë prej 0.5% ne muaj apo pjesë të muajit, por jo me shumë se 6% (12 muaj).

E saktë

E pasaktë

5. Sipas Ligjit nr. 05/L-028 Për Tatimin në të Ardhurat Personale, periudha tatimore për bizneset individuale që kanë një qarkullim nën 50,000 Euro dhe që nuk janë të regjistruar në fitimin real, është çdo tremujorësh.

E saktë

E pasaktë

6. Sipas Ligjit mbi Pensionet në Kosovë, pagesa e kontributeve është e detyrueshme për të gjithë banorët e punësuar të Kosovës dhe të punësuarit e huaj deri në moshën e pensionimit.

E saktë

E pasaktë

7. Sipas ligjit nr. 06/L-105 Për Tatimin ne te Ardhurat e Korporatave, një tatimpagues me të ardhura vjetore bruto prej 30.000 Euro apo më pak për te zgjedhur që të përgatitin pasqyrat financiare dhe te paguaj tatim ne fitimin real duhet të dorëzojë një kërkesë për regjistrim në ATK, deri më 1 Mars të vitit aktual për të cilin tatimpaguesi kërkon te regjistrohet.

E saktë

E pasaktë

8. Sipas ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, çdo shumë e tatimit e paguar mbi shumën e detyrimit tatimor (mbipagesë) përjashtuar Tvsh-në, me kërkesën e tatimpaguesit do të kreditohet ndaj detyrimit aktual të tatimpaguesit për detyrimin tatimore të llogarive të ndryshme tatimore.

E saktë

E pasaktë

9. Sipas ligjit të Tvsh-së, çdo person është i obliguar që të regjistrohet për Tvsh nga momenti i kalimit të qarkullimit prej tridhjetëmijë Euro (30.000€), brenda vitit kalendarik dhe duhet të njoftojë ATK-në brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike prej momentit kur ka lindur obligimi për regjistrim.

E saktë

E pasaktë

10. Bazuar në Ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat, një tatimpagues mundet të dorëzojë një ndryshim deklarate tatimore nëse ai ose ajo më vonë zbulon gabim në deklaratën tatimore të cilën e ka dorëzuar tashmë. Afati për të dorëzuar një ndryshim deklarate është jo më vonë se katër (4) vjet pas datës obligative kur deklarata është dorëzuar fillimisht.

E saktë

E pasaktë

11. Blerjet për të cilat një faturë është lëshuar duhet të futet në librin e blerjeve brenda 10 ditëve pas pranimit të faturës së blerjes. Shitjet për të cilat një faturë e shitjes është lëshuar duhet të futet në librin e shitjeve brenda 10 ditëve pas lëshimit të faturës së shitjes.

E saktë

E pasaktë

12. Gjatë ose pas regjistrimit në ARBK, një Shoqëri Tregtare, duke përfshirë Bizneset Individuale mund të dorëzojnë aplikacion në ARBK për shfrytëzimin e një Emri Tregtar që është i ndryshëm nga Emri Zyrtar i Shoqërisë Tregtare.

E saktë

E pasaktë

13. Sipas dispozitave të ligjit nr. 03/L-162 Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, shpenzimet për përmirësimin e pronave me qira të cilat përdoren për veprimtari ekonomike të tatimpaguesit do të kompensohen përmes zbritjeve të zhvlerësimit të llogaritura me metodën lineare për periodën e kohëzgjatjes së qirasë.

E saktë

E pasaktë

14. Sipas ligjit nr. 06/L-032 për “Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim”, për qëllime të këtij Ligji, klasifikohen si mikro-ndërmarrje, ndërmarrje të vogla, ndërmarrje të mesme dhe ndërmarrje të mëdha, mbi bazën e treguesve të përcaktuar në ditën e fundit të vitit të kaluar financiar, për qëllime të përgatitjes së pasqyrave financiare për vitin aktual, sipas kritereve të mëposhtme:

1. pasqyra e pozitës financiare;
2. qarkullimi vjetor neto; dhe
3. numrin mesatar të puntorëve.

E saktë

E pasaktë

15. Sipas ligjit nr. 06/L-032 për “Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim”, raporti i auditimit nënshkruhet nga auditori ligjor, ku firmoset edhe data e nënshkrimit; kur një firmë auditimi kryen auditimin, raporti i auditimit nuk nënshkruhet nga auditori ligjor që kryen auditimin në emër të firmës së auditimit;

E saktë

E pasaktë

16. Sipas Ligjit të Punës, Kontrata e Punës mund të lidhet për:

1. një periudhë të pacaktuar;
2. një periudhë të caktuar; dhe
3. punë dhe detyra specifike.

17. Shkalla e akcizës që zbatohet për disa produkte ka vetëm vlerë fikse dhe nuk aplikohet shkallë e caktuar e përqindjes.

E saktë

E pasaktë

18. Sipas ligjit nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale, shpenzimet për ndjekje të programit të trajnimit të paguara nga një punëdhënës për një të punësuar për të marrë pjesë në programet zyrtare të trajnimit për të marrë shkathhtësitë që lidhen me punën, lejohen pjesërisht (maksimum 500 Euro për punonjës) në vitin në të cilin shpenzimet e tilla të trajnimit kanë ndodhur.

E saktë

E pasaktë

19. Sipas ligjit nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale, shuma e humbjes tatimore e përcaktuar sipas këtij neni mund të bartet deri në katër (4) vite të njëpasnjëshme tatimore dhe është e disponueshme si zbritje ndaj çfarëdo të ardhure për ato vite.

E saktë

E pasaktë

20. Sipas ligjit nr. 05/L-105 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, shpenzimet e përfaqësimit do të jenë të kufizuara në dy përqind (2%) të të ardhurave bruto vjetore ndërsa sipas ligjit nr. 05/L-029 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave ato kanë qenë një përqind (1%) të të ardhurave bruto vjetore.

E saktë

E pasaktë

Problemi 1

15 pikë

Kompania BLENDI shpk me seli në Prishtinë kryen disa aktivitete ekonomike dhe gjatë muajit Shkurt 2020 ka këto transaksione: shitjet brenda vendit me norme 18% - shuma e tatushme 60,000 Euro, shërbime transportit Prishtinë-Durres 8,800 Euro, blerjet nga bizneset të cilat nuk janë të regjistruar në Tvsh 4,100 Euro, import nga Franca (kamion) i cili nevojitet për shërbime transporti me vlerë të faturës prej 15,000 Euro (nuk ka patur akcize dhe rivlerësim doganor), blerje e një veture në vlerë prej 35,000 Euro nga një biznes vendor (me norme standarde) i cili konsiderohet si veturë luksi, notë kreditore e lëshuar me norme 18% me vlerë të Tvsh-së prej 810 Euro, shpenzime të rrymes ujit etj të cilat i nënshtrohen normës së reduktuar 800 Euro (shuma e tatushme).

Poashtu gjatë këtij muaji ka pranuar shërbime të nga jashtë vendit në vlerë prej 2,500 Euro (ngarkesë e kundërt).

Vlerat e paraqitura janë pa përfshire Tvsh-në.

Kërkohet:

Përpiloni ekstraktin e deklaratës së Tvsh-së sipas renditjes se sa ka pagesë/kreditim për muajin 02/2020 biznesi në fjalë duke marrë parasysh obligimin që ka patur në muajin Janar 2020 prej 1,000 Euro.

Zgjidhje: Ekstrakt i deklaratës mujore Shkurt 2020:

[TV] FORMULARI I DEKLARIMIT TË TVSH			
Periudha e Deklarimit:	Kolona [1]	02	2020
Numri Fiskal:	Kolona [3]	600700800	
Emri i biznesit:	Kolona [4]	BLENDI shpk	
Adresa e biznesit:	Kolona [5]	PRISHTINË, KOSOVË	
Emri i personit kontaktues dhe telefoni:	Kolona [6]	Fistek Filani 044/123123	
		Furnizimet Vlera	TVSH
Shitjet e liruarat me të drejtë kreditimi	Kolona [10]	8,800	
Shitjet e tatueshme me normën 18%	Kolona [12]	60,000	10,800
Blerjet që i nënshtrohen ngarkesës së kundërt	Kolona [28]	2,500	450
		Kolona [30]	11,250
		Blerjet Vlera	TVSH
Blerjet dhe importet pa TVSH	Kolona [31]	4,100	
Blerjet dhe importet investive me TVSH jo të zbritshme	Kolona [34]	20,650	
Importet investive me normë 18%	Kolona [39]	16,500	2,970
Blerjet vendore me normë 8%	Kolona [45]	875	70
Blerjet investive vendore me normë 18%	Kolona [47]	17,500	3,150
Nota debitoare e pranuar, nota kreditore e lëshuar me normë 18%	Kolona [53]	4,500	810
E drejta e kreditimit të TVSH-së në lidhje me ngarkesën e kundërt me normë 18%	Kolona [65]	2,500	450
		Kolona [67]	7,450
		Kalkulimi Vlera	
Teprica a TVSH-së e bartur nga muaji i kaluar	Kolona [68]	-	
Balanca kreditore e mbetur $69 = ((67+68)-30) > 0$	Kolona [69]	-	
Kërkesa për rimbursim	Kolona [70]	-	
Kreditimi i tvsh-së per muajin pasues $71 = (69-70)$	Kolona [71]	-	
TVSH që duhet të paguhet $72 = (30-67-68) > 0$	Kolona [72]	3,800	

Sqarim: Blerjet dhe importet me Tvsh jo të zbritshme :

$(35,000 \times 50\%) = 17,500$ (pjesa e kostos)
 plus(+) $35,000 \times 50\% \times 18\%$ = 3,150 (pjesa e Tvsh-së së pazbritshme)
 Total = 20,650

Blerjet investive vendore me normë 18%: $35,000 \times 50\% = 17,500$

Problemi 2**12 pikë**

Kompania LURA shpk me seli në Prizren, e regjistruar me TVSH ka prezantuar informatat në vijim sa i përket aktivitetit të saj afarist për 6 mujorin e parë të vitit:

Shitjet e tatueshme : 135,700 euro (përfshirë TVSH 18%)
 Pagat : 14,500 euro (përfshirë KP të punëdhënësit)
 Blerjet: 69,974 euro (përfshirë TVSH 18%)
 Shp. e zhvleresimit : 8,100 euro
 Stoqet në fillim të vitit : 27,200 euro (me kosto)
 Stoqet në fund te vitit: 31,500 euro (me kosto)
 Shpenzimet tjera me fature (përfshirë TVSH 18%): 5,251.00 euro
 Shpenzimet tjera me fature (pa TVSH): 10,728.00 euro
 Shpenzime familjare të paguara me kartelë të biznesit 500 euro.
 Norma e tatimit në fitim është 10%.

Kërkohe:

- a) Të përpilohet pasqyra e të ardhurave sipas ligjit TAK ? **8 pikë**
 b) Sa është marzha Bruto dhe Neto mbi shitjet për periudhën e vitit ? **4 pikë**

Zgjidhje:

			Sqarimet:
Shitjet		115,000	<----- (135,700/1.18)
KMSH			
Stoqet në fillim	27,200		
+Blerjet	59,300		<----- (69,974/1.18)
-Stoqet në fund	31,500		
		<u>(55,000)</u>	
Fitimi Bruto		60,000	
Shpenzimet e pagave		(14,500)	
Shpenzimet e zhvleresimit		(8,100)	
Shpenzimet tjera (me TVSH)		(4,450)	<----- (5,251/1.18)
Shpenzimet tjera (pa TVSH):		<u>(10,728)</u>	
Fitimi para tatimit		22,222	
Tatimi @10%		<u>(2,222)</u>	
Fitimi Neto		20,000	
Marzha bruto mbi shitjet:	60,000/115,000= 52.17%		
Marzha neto mbi shitjet:	20,000/115,000= 17.39%		

Problemi 3

7 pikë

Kompania JONI shpk për vitin 2019 ka pasur një fitim neto prej 225,000 Euro dhe tatim në të ardhurat e korporatave bazuar në deklaratën përfundimtare në vlerë prej 25,000 Euro.

Parapagimi i kësteve të barabarta ka qenë në shumë prej 5,600 EUR (metoda historike), diferenca prej 2,600 Euro është paguar me deklaratë përfundimtare me 31 mars 2020.

Bazuar në vendimin e menaxhmentit të kompanisë për vitin 2020 parapagimi i tatimit në të ardhurat e korporatave nuk do të vazhdoje të paguhet bazuar në metodën e “**strehës së sigurt**”, pasi është planifikuar se sipas buxhetimit fitimi para tatimit (FPT) do të jetë rreth 420,000 Euro për vitin 2020 dhe i cili do të jetë i njëtrajtshëm gjatë gjithë vitit 2020.

Kërkoet:

Sa do të jetë shuma minimale e një kësti për vitin 2020 për Kompaninë “JONI shpk” nëse aplikohet metoda e parashikimit.

Zgjidhje:

Për periudhen vijuese të vitit 2020, paguhet minimum 80% i një të katërtës (1/4) së detyrimit tatimor të parashikueshëm (në këtë rast të vitit 2020), ku detyrimi tatimor i parashikueshëm ishte 42,000 Euro (FPT 420,000x10%).

Kalkulimi për këstet paradhënje tremujore të tatimit ne fitim për vitin 2020:

$42,000 \times \frac{1}{4} = 10,500 \text{ Euro} \times 80\% \text{ (minimumi për mos ndëshkime)} = 8,400 \text{ Euro.}$

Problemi 4**10 pikë**

Kompania VESA LLC më datë 31.12.2019 kishte ketë shpenzim të zhvlerësimit sipas kontabilitetit:

- Grupi I - 8,500
- Grupi II - 12,000
- Grupi III - 22,000

Për grupin e parë kompania kishte një politike të zhvlerësimit 4% në vit, për grupin e dytë 8%, për grupin e tretë 15%. Kompania me 1 Gusht të vitit 2019 kishte blerë një aset të grupit të tretë në vlerë prej 22,000 Euro (zhvlerësuar sipas muajit për qëllime kontabël). Të gjitha asetet tjera janë blerë gjatë vitit 2017.

Kërkohet:

a) Llogaritni ndryshimin e zhvlerësimit në mes të kontabilitetit financiar dhe kontabilitetit të tatimeve sipas grupeve?

Zgjidhje:**Grupi I**

Kontabiliteti	$212,500 \times 4\% = 8,500$
Tatimet	$212,500 \times 5\% = 10,625$
<hr/>	
Δ Rritje e shpe. të zhvlerësimit	2,125

Sqarim: $8,500 / 4\% = 212,500$

Grupi II

Kontabiliteti	$150,000 \times 8\% = 12,000$
Tatimet	$150,000 \times 20\% = 30,000$
<hr/>	
Δ Rritje e shpe. të zhvlerësimit	18,000

Sqarim: $12,000 / 8\% = 150,000$

Grupi III

Kontabiliteti aset i ri	$(24,000 \times 15\% = 3,600 / 12 \times 5) = 1,500$
Kontabiliteti	$136,666.67 \times 15\% = 20,500$
Total për Kontabiliteti	22,000
<hr/>	
Tatimet aset i ri	$24,000 \times 10\% / 2 = 1,200$
Tatimet	$136,666.67 \times 10\% = 13,667$
Totali për Tatime	14,867
<hr/>	
Δ Zvogëlim i shp. të zhvlerësimit	7,133

Sqarim: $22,000 - 1,500 = 20,500$

$20,500 / 15\% = 136,666.67$

Problemi 5**8 pikë**

Kompania NOARI shpk ka të punësuar 2 persona. Paga e të punësuarve për muajin Mars 2020 janë si me poshtë:

	Paga Neto
Menaxheri :	1,200 Euro
Punëtori 1	620 Euro

Kërkohe:

Llogaritni detyrimin e tatimit në paga dhe KP për muajin Mars 2020 të këtyre të punësuarve (Kujdes pagat janë neto).

Zgjidhje**1. Menaxheri: paga Mars = 1,200**

	a	b	c=axb	d=a-c	
	Paga e tatueshme	Shkalla e tat.	Paga	Neto	Kumulative Paga Neto
1.	80	0%	0	80.00	80.00
2. (1*)	170	4%	6.8	163.20	143.20
3. (2*)	200	8%	16	184.00	427.20
4.(3*)	858.67	10%	85.87	772.80 (3*)	1,200.00
TOTAL	1,308.67		108.67	1,200	

KP: Paga bruto $1,308.67/95\% = 1,377.54$

KP = $1,377.54 \times 5\% = 68,87 + 68.87 = 137.75$

(1*) diferenca e pages nga 80 - 250 = 170

(2*) diferenca e pages nga 250 - 450 = 200

(3*) diferenca e pages neto $80+163.20 +184= 427.20$

Paga neto e menaxherit $1200 - 427.20 = 772.80/90\% = 858.67$

2. Punëtori 1: paga Neto për muajin Mars = 620

	a	b	c=axb	d=a-c
	Paga e tatueshme	Shkalla e tat.	Tatimi	Paga Neto
1.	80	0	0	80.00
2. (1*)	170	4%	6.8	163.20
3. (2*)	200	8%	16.00	184.00
4.(3*)	214.22	10%	21.42	192.80
TOTAL	664.22		44.22	620.00

KP: Paga bruto $664.22/95\% = 699.18$
KP = $699.18 \times 5\% = 34.96 + 34.96 = 69.92$

(1*) diferenca e pages nga 80 - 250= 170

(2*) diferenca e pages nga 250 - 450= 200

(3*) diferenca e pages neto $80+163.20 +184= 427.20$

Paga neto e menaxherit $620- 427.20= 192.80/90\% = 214.22$

	Paga Bruto	Tatimi	Pensioni	Pensioni	Paga Neto
Menagjeri	1,377.54	108.67	68.87	68.87	1,200.00
Punetori 1	699.18	44.22	34.96	34.96	620.00
TOTAL	2,076.72	152.89	103.83	103.83	1,820.00

Problemi 6

8 pikë

Kompania FLANDRA shpk gjatë muajit Shkurt 2020 ka pasur tri objekte/lokale të marra me qira me kontratë mujore:

Lokali 1: Qiraja 500.00 Euro përfshirë Tvsh-në

Lokali 2: Qiraja neto 500,00 Euro si dhe

Lokali 3: Qiraja bruto 500 Euro.

Vlerat përkatëse të qirasë janë paguar gjatë muajit Shkurt 2020.

Kërkohet:

Të kalkulohet tatimi i mbajtur në burim (pjesa e qirasë) për muajin Shkurt 2020?

Zgjidhje:

Lokali 1: $500/1.18 = 423.73$ Euro bruto (bazë për kalkulim)

Lokali 2: 500 Euro neto => 549.45 bruto (bazë për kalkulim)

Lokali 3: 500 Euro bruto (bazë për kalkulim)

Total bruto Lokali 1+ Lokali 2+Lokali 3= $423.73+549.45+500.00= 1,473.18$

Tatimi i mbajtur në burim : $1,473.18 \times 9\% = 132.59$